



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
(Komision për dhënie mendimi)

Tiranë më, 15.11.2022

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”
(nen për nen)

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 dhe nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, pas miratimit në parim në seancë plenare, nisi shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2023”, në mbledhjen e datës 15 nëntor 2022.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit nen për nen të projektbuxhetit të vitit 2023 ishin përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2023” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 30, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Diskutimi në komision***

Gjatë diskutimeve, Komisioni u njoh edhe njëherë me disa kërkesa për lëvizje dhe shtesë fondesh të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe me kërkesën për një shtesë fondi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Kërkesat për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

- 1- Në llogarinë 600 dhe 601, nga përllogaritjet për zërin paga e sigurime shoqërore, mbështetur në numrin e punonjësve sipas organikës së MTM dhe në bazë të ristrukturimit të kërkuar të organikës të të gjithë strukturës së MTM-së, të bëhen ndryshimet si më poshtë të detajuara në nivel programi dhe llogarie ekonomike:

Llogaria 600

a. “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”	83,490,000 lekë
b. “Administrimi i Pyjeve”	253,100,000 lekë
c. “Zhvillimi i Turizmit”	112,200,000 lekë
d. “Mbrojtja e Mjedisit”	279,000,000 lekë
Totali i llogarisë 600	727,790,000 lekë

Llogaria 601

a. “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”	13,600,000 lekë
b. “Administrimi i Pyjeve”	42,100,000 lekë
c. “Zhvillimi i Turizmit”	18,600,000 lekë
d. “Mbrojtja e Mjedisit”	46,500,000 lekë
Totali i llogarisë 601	120,800,000 lekë

Totali i llogarisë 600 dhe 601 ***848,590,000 lekë***

- 2- Në shpenzimet kapitale, në programin “Administrimi i Pyjeve”, të bëhet ndryshimi brenda llogarive të investimeve, konkretisht në llogarinë 231 (investime) të zbriten 53,350,000 lekë dhe në llogarinë 230 (hartim projekti) të shtohet kjo vlerë prej 53,350,000 lekë.
- 3- Në shpenzimet kapitale, në programin “Administrimi i Pyjeve”, në bazë të buxhetit të propozuar, është parashikuar për vitin 2023 një vlerë prej 102,900,000 lekë për Zbatim Projekti “Ngritja e Infrastrukturës me theks tek ajo Ujore Eko-Park Ulza” dhe në vijim kërkohet shtesë fondi për diferencën prej 203,900,000 lekë, respektivisht për vitin 2024 vlera shtesë 101,950,000 lekë dhe për vitin 2025 vlera shtesë 101,950,000 lekë, për të patur të mbuluar vlerën totale të projektit rreth 500,000,000 lekë (projekti i zbatimit përfundon në dhjetor të këtij viti).

Kërkesat për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Në Fondet buxhetore të parashikuara për financimin dhe mbështetjen e kontratave të mirëmbajtjes rrugore, duke qenë se janë të pamjaftueshme për vitin 2023, kërkohet një rritje e tavanit buxhetor në vlerën rreth 1.2 miliard lekë.

- *Ndryshime të projektligjit*

Pasi u njoh me nevojat e mësipërme të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Komisioni i miratoi ato me shumicë votash, dhe i sugjeron Komisionit për Ekonominë dhe Financat miratimin e tyre.

- *Përfundim*

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me shumicë votash, vendosi miratimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2023”.

Laert DURAJ

Arben PËLLUMBI

Relator

Kryetar